



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 373 prot.

Elbasan, më 04.02.2021

VENDIM

Nr 04 datë 04.02.2021

**"PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN
E STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR
XHUVANI"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, gërma "d", Statutit të UE-së, neni 9, gërma "d", Rregulloren e Studimeve në UE-së, me propozim të Rektoratit të UE-së Senati Akademik më datë 04.02.2021,

V E N D O S I:


I. Në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 3 datë 28.01.2020 "Për Miratimin e Rregullores së studimeve në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Përmbajtja e nenit 38 "Rifillimi i studimeve" ndryshon si më poshtë:

1. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, si dhe ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj IAL-së, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër.
2. Aplikanti për rifillimin e studimeve u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të Fakultetit përkatës.
3. Formulari i Aplikimit për rifillimin e studimeve, së bashku me dokumentacionin shoqërues, paraqitet përpara fillimit të vitit akademik, pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit përkatës.
 - a) Formulari i Aplikimit për rifillimin e studimeve duhet të përmbajë të paktën të dhënat: emër, atësi, mbiemër, datëlindje, adresë banimit në Shqipëri, nr. telefoni, adresë e-mail; programin e studimit ku kërkon të rifillojë studimet programin e studimit të frekuentuar deri në momentin e kërkesës dhe vitin akademik të fillimit të studimeve;
 - b) Formulari i Aplikimit për rifillimin e studimeve duhet të shoqërohet me *Listë notash* të lëndëve dhe krediteve që ka shlyer aplikanti në programin e studimit të frekuentuar prej tij.

Përjashtimisht për vitin akademik 2020-2021 kërkesat për rifillimin e studimeve bëhen në fillim të çdo semestri.

4. Formulari i Aplikimit për rifillimin e studimeve, së bashku me dokumentacionin shoqërues i përcillen Departamentit përkatës, i cili mbulon programin e studimit ku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

aplikanti kërkon të rifillojë studimet. Nga Departamenti ndiqet procedura si më poshtë:

- a) Komisioni "ad hoc" i ekuivalentimit, i ngritur nga njësia bazë përkatëse dhe miratuar nga dekani, bën verifikimin e plotësimit të kriterëve të pranimit dhe njohjen e krediteve të fituara nga aplikanti, i cili kërkon rifillimin e studimeve në UE. Ky komision do të përfshijë personel akademik që i përshtaten profileve dhe fushave të studimit sipas krediteve që aplikanti ka shlyer dhe kërkon të njohë.
- a) Komisioni "ad hoc" merr vendim për secilin aplikant:
 - i cili nuk plotëson kriteret për rifillimin e studimeve, duke argumentuar arsyen e mosplotësimit.
 - i cili i plotëson kriteret për rifillimin e studimeve. Në këtë rast komisioni "ad hoc" shprehet për njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve. Në vendim përcaktohen edhe lëndët që studenti duhet të shlyejë në programin e studimit ku kërkon të rifillojë studimet. Vendimi i komisionit për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve miratohet nga Dekani.
5. Të gjitha vendimet e miratuara sipas pikës 5 të këtij neni, i përcillen Rektoratit të UE-së, me shkresë përcjellëse të Dekanit të njësisë kryesore.
6. Rektorati, bazuar në numrin e kuotave dhe kriteret e pranimit, merr vendim:
 - për secilin aplikant të cilit nuk i miratohet kërkesa për rifillimin e studimeve.
 - për secilin aplikant të cilit i miratohet kërkesa për rifillimin e studimeve, duke përcaktuar edhe vitet akademike që do të frekuentojë ai.
7. Studenti i cili rifillon studimet do të paguajë tarifat përkatëse të shkollimit për vitet akademike që do të frekuentojë, ndërsa për programet e ciklit të dytë do të paguajë vetëm tarifat për kreditet e lëndëve që do të shlyejë.

II. Ngarkohen të gjitha njësitë akademike dhe ndihmësakademike të UE-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Skender TOPI

